



## **LEGJISLACIONI NË FUSHËN E SIGURISË KIBERNETIKE**

**AKSK**

## □ HYRJE

01

**Ligji nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore për implementimin e tij.**

02

**Zbatimi i ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” në sektorët kyç.**

03

**Detyrimet e operatorëve të infrastrukturave të informacionit sipas ligjit nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.**

04

**Raportimet.**

# HYRJE

- ❖ **Siguria kibernetike** përfshin tërësinë e masave të domosdoshme për mbrojtjen e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, përdoruesve të tyre, dhe individëve të prekur nga kërcënimet kibernetike. Në një kohë kur Shqipëria po përjeton një transformim të shpejtë digjital, me rritjen e ndjeshme të përdorimit të teknologjive të informacionit dhe zhvillimin e infrastrukturës përkatëse, rëndësia e sigurisë kibernetike është më e madhe se kurrë.
- ❖ Rritja gjithnjë e më shumë e numrit të digjitalizimit të shërbimeve në shumë sektorë shton edhe mundësinë e incidenteve kibernetike në rrjetet dhe sistemet e informacionit të cilat mund të çojnë në rënien e ofrimit të këtyre shërbimeve deri në cenim të sigurisë kombetare.
- ❖ Ky webinar synon të ofrojë një panoramë të plotë mbi kornizën ligjore të sigurisë kibernetike në Shqipëri, me fokus të veçantë në përcaktimet e ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" dhe aktet nënligjore që rregullojnë zbatimin e tij.

# Ligji nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore për implementimin e tij.

- ❑ Ligji “Për sigurinë kibernetike”, u miratua në datën **21.03.2024**i cili hyri në fuqi në datën **03.05.2024**. Ligji është përafruar pjesërisht me **Direktivën NIS 2 të BE** (Direktiva nr. 2022/2555, të Parlamentit dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, “Mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian, e cila ka ndryshuar rregulloren (BE) nr. 910/2014 dhe direktivën (BE) nr. 2018/1972, si dhe ka shfuqizuar direktivën (BE) nr. 2016/1148.)
- ❑ **Ligji Nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”** përbën një nismë të rëndësishme legislative që synon forcimin e kapaciteteve mbrojtëse ndaj kërcënimeve kibernetike dhe garantimin e një mjedisi digjital të sigurt dhe të besueshëm.
- ❑ Ky ligj ofron një kuadër ligjor të qëndrueshëm dhe transparent duke garantuar një nivel të lartë të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar duke krijuar mekanizmat e nevojshëm dhe vendosur rregulla të qarta për të gjithë palët e përfshira.

# Ligji nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore për implementimin e tij.

- ❖ **Objekti i ligjit** është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve publike dhe private, të cilat administrojnë infrastruktura të informacionit, rrjetet e komunikimit dhe sistemet e tyre, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt në shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë.
- ❖ **Ky ligj përcakton gjithashtu:**
  - ✓ autoritetin përgjegjës për sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë;
  - ✓ ekipet e përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike, si: CSIRT-in Kombëtar, CERT-in, CSIRT-et;
  - ✓ autoritetin përgjegjës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike;
  - ✓ masat e sigurisë kibernetike dhe masat e menaxhimit të rrezikut të sigurisë kibernetike, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga subjektet e përmendura në anekset I dhe II ligjit për sigurinë kibernetike;
  - ✓ detyrimin për raportimin e incidenteve të sigurisë kibernetike
  - ✓ rregullat dhe detyrimet për ndarjen e informacionit të sigurisë kibernetike.

# Ligji nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore për implementimin e tij.

- ❖ **Qëllimi i ligjit** është përcaktimi i masave të sigurisë me qëllim arritjen e një niveli të lartë të sigurisë kibernetike për rrjetet dhe sistemet e informacionit në Republikën e Shqipërisë.
- ❖ **Fusha e zbatimit** Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha subjektet publike dhe private, që administrojnë sisteme dhe rrjete të informacionit, sipas përcaktimeve të bëra në anekset I dhe II të ligjit.

# Ligji nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore për implementimin e tij.

## □ Përmbledhje e përcaktimeve të ligjit për sigurinë kibernetike:

- Përcakton dispozita që parashikojnë strukturat dhe mekanizmat e nevojshme për garantimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, si dhe procedurave të lidhura me to.
- Ka parashikime të qarta ligjore lidhur me administrimin e sigurisë kibernetike.
- Përcakton skemën e certifikimit të sigurisë kibernetike në përputhje me skemat e certifikimit të Bashkimit Evropian.
- Rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë kibernetike.

# AKTET NËNLIJORE

## ☐ Miratuar:

- ❖ Metodologjia për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit me VKM Nr. 683, datë 6.11.2024, "Për miratimin e metodologjisë për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit".
- ❖ Rregullorja për Kategorizimin e Incidenteve të Sigurisë Kibernetike , me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit, nr.299, datë 21.08.2024.
- ❖ Rregullorja “Për mënyrat dhe afatet e ruajtjes së Log-eve të incidenteve të sigurisë kibernetike”, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit nr.408 datë 07.11.2024.
- ❖ Rregullorja “Mbi procedurat e menaxhimit të incidenteve të sigurisë kibernetike, kundërmasat dhe playbooks”, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit.

## ☐ Në process:

- ❖ Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe analizimin e sigurisë kibernetike”, i cili është dërguar në KM për procedurat e mëtejshme.
- ❖ Plani kombëtar i menaxhimit të incidenteve në shkallë të gjerë dhe krizave kibernetike si dhe një sërë aktesh të tjera të nevojshme për implementimin e ligjit.
- ❖ Projektvendim i Këshillit të Ministrave Identifikimi, klasifikimi, përshkallëzimi, menaxhimi i krizës kibernetike.



# AKTET NËNLIJORE

## □ Në process:

- ❖ Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plani I Veprimit 2025-2030
- ❖ Masat e sigursë kiberneike

# ZBATIMI I LIGJIT NR. 25/2024 “PËR SIGURINË KIBERNETIKE” NË SEKTORËT KYÇ

- Ligji përcakton në **anekset e tij sektorët me kritikalitet të lartë dhe sektorët e tjerë kritikë** mbi bazën e të cilëve bëhet edhe identifikimi I operatorëve të infrastrukturave të informacionit.
- **Sektorë me kritikalitet të lartë:** Energjia, Transporti, Bankar, Infrastruktura e tregjeve fiannciare, shëndetësor, Subjektet që ofrojnë shërbime ose hostojnë sisteme për përpunimin dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar, që lidhen më sigurinë publik, Furnizimi me ujë të pijshëm, Ujërat e zeza, Infrastrukturat digjitale, Menaxhimi i shërbimeve TIK (biznes me biznes), Administrata publike, Hapësira , Sektori arsimor, Turizmi.
- **Sektorë të tjerë kritik** si : Postar dhe shërbimet e korrierit, Menaxhimi i mbetjeve, Prodhimi, përpunimi dhe shpërndarja e kimikateve, Prodhimi, procesimi dhe shpërndarja e ushqimit, Prodhimi, Ofruesit e shërbimeve digjitale.

# DETYRIMET E OPERATORËVE TË INFRASTRUKTURAVE TË INFORMACIONIT

- Përbushja e masave të sigurisë kibernetike
- Masat korigjuese
- Raporti të vlerësimit të konformitetit për implementimin efektiv të masave të sigurisë kibernetike
- Bashkëpunimi
- Raportimi i incidenteve të sigurisë kibernetike.
- Detyrimi i raportimit të të gjitha infrastrukturat e tyre kritike, të rëndësishme;



**FALEMINDERIT**